



Datë: 10.12.2025

Numër protokoli: 7823/2025

A.nr.1870/2025

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1870/2025, të datës, 05.11.2025, të parashtruar nga ankuesja M.D.K, kundër organit të punësimit: Organi Shqyrtues i Prokurimit, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 10.12.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.1870/2025, e datës 05.11.2025, e parashtruar nga ankuesja M.D.K.

II. Mbetet në fuqi Njoftimi i datës 28.10.2025, i Njesisë së Burimeve Njerëzore të Organit Shqyrtues të Prokurimit për shpalljen e rezultateve përfundimtare.

A r s y e t i m

Ankuesja, M.D.K (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*), më datë 05.11.2025 ka parashtruar ankesë nëpërmjet e-mailit ankesa.kpmshek@rks-gov.net, me numër protokoli 7172/2025 në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit sipas konkursit me numër reference RN00017734, për pozitën “*Zyrtar për Arkiv 2*”, të shpallur nga Organi Shqyrtues i Prokurimit.

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar Këshilli*), bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit më datë 07.11.2025 në OSHP, ndërsa Këshilli më datë 14.11.2025 ka pranuar përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën e ankueses të parashtruar në Këshill me numër protokolli:7172/2025 e datës 05.11.2025; Ankesën e datës 31.10.2025; E-mailin e datës 05.11.2025 dërguar nga ankuesja në Këshill; Njoftimin e rezultateve të testit me shkrim; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 07.11.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 14.11.2025; Vendimin e datës 16.10.2025 me akt emërimet e anëtarëve të Komisionit të Pranimit; Njoftimin e datës 22.10.2025 për kandidatin e suksesshëm; Njoftimi për rezultatet përfundimtare i datës 28.10.2025; Njoftimin e datës 13.06.2025; Njoftimin e datës 22.10.2025; Njoftimin e datës 24.10.2025; Testin me shkrim të kandidatës B.A; Testin me shkrim të ankueses; Testin me shkrim të kandidatës së suksesshme; Formularët e vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatin në intervistë të datës 27.10.2025; Aplikacionin e kandidatës B.A i datës 30.04.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur prej 16 faqe; Ankesën e ankueses të parashtruar në Këshill me numër protokolli:5071/2025 e datës 23.07.2025; Vendimin e Këshillit me shifër VK/2025 dhe numër protokolli: 5953/2025; Konkursin e datës 29.04.2025; Njoftimin e datës 13.06.2025 për fazën e verifikimit paraprak; Njoftimin e datës 02.07.2025 për Rezultatet Përfundimtare; Vërtetimin e datës 09.11.2018; Vërtetimin e datës 06.01.2016; Vërtetimin e datës 08.02.2016; Shkresë e datës 18.02.2015; Kopjen e ID së ankueses; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 04.08.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 20.08.2025; Listën e aplikantëve; Formularët e vlerësimeve të eses nga anëtarët e Komisionit të Pranimit; Formularët e vlerësimit individual të anëtarit të komisionit për kandidatët në procedurë të datës 02.07.2025; Listën përfundimtare të vlerësimit; Formularin e renditjes përfundimtare të datës 02.07.2025; Vendimin e datës 16.06.2025 për themelimin e Komisionit të pranimit me akt emërimet e anëtareve të komisionit; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e shpallur; Testet me shkrim të kandidatëve; Aplikacionin e kandidatës N.G i datës 30.04.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur prej 52 faqes; Aplikacionin e ankueses i datës 01.05.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur prej 19 faqes; Aplikacionin e kandidatës A.A i datës 30.04.2025 me dokumentacionin e bashkangjitur prej 52 faqe; Kërkesë e datës 16.09.2025; Përgjigje e datës 16.09.2025; Akt Emërimin e datës 29.08.2025 me shifër Nr.1214/2025; Akt Emërimin e datës 29.08.2025 me shifër Nr.1215/2025; Akt Emërimin e datës 29.08.2025 me shifër Nr.1219/2025; Akt Emërimin e datës 07.08.2024 me shifër Nr.04/2024; Akt Emërimin e datës 31.07.2024 me shifër Nr.03/2024.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në legjislacionin përkatës të zyrtarëve publik si dhe provat që janë dërguar nga palët në procedurë sipas kërkesës së Kolegjit të Këshillit , ka konstatuar se ankesa e ankueses është ***e pabazuar***, sepse:

Nga analizimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se Organi Shqyrtues i Prokurimit , më datë 29.04.2025, ka shpallur Konkursin publik me numër Reference RN00017734, gjegjësisht për pozitën e punës, “Zyrtar për Arkiv 2”, me afat për aplikimi nga data 30.04.2025 deri më datë 29.05.2025.

Tutje, bazuar në shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar gjithsejtë 11 kandidatë, të cilët kriteret i kanë plotësuar 60 kandidatë, në mesin e tyre edhe ankuesja, e cila i është nënshtruar testimit me shkrim të kësaj procedure rekrutimi, mirëpo ka arritur të marr vetëm 48.2 pikë, të cilat nuk ka qenë të mjaftueshme për të kaluar testin me shkrim nga 50 pikë sa është e nevojshme për të vazhduar në procedurën e rekrutimit, respektivisht intervistës me gojë, sikurse përcaktohet me dispozitat e aplikuara nga Rregullorja Nr.15/2023 Për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, neni 10 paragrafi 2 ku

përcaktohet se: ‘2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën pesëdhjetë (50) pikë në testimin me shkrim, kanë të drejtë të marrin pjesë në intervistë’, ndërsa sipas listës përfundimtare të kandidatëve kandidatja A.A është renditur e para në këtë listë me gjithsejtë 83.8, ashtu që sipas Njoftimit të datës 28.10.2025 të renditjes përfundimtare të kandidatëve të Divizionit të Burimeve Njerëzore në organin përkatës të punësimit, rezulton se kandidate fituese është kandidatja A.A e cila ka marr më shumë pikë, gjithsejtë 83.8 prej të cilave 59 në testin me shkrim, ndërsa 24.8 në intervistën me gojë.

Ankuesja, e pa kënaqur me rezultatet përfundimtare për kandidatët e suksesshëm, në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se procedura e rekrutimit është përcjellë me parregullsi dhe mungesë të objektivitet ashtu dhe me mundësi të manipulimit të procesit të testimit, me kërkesën që të rishqyrtohet procesi i vlerësimit për shkak që pyetjet s’kanë qenë të lidhura me pozitën, përbërja e komisionit dhe mënyra e vlerësimit, me arsyetimin se komisioni i pranimit me rastin e mbajtjes së testit me shkrim nuk ka qenë prezent në përbërje të plotë në sallë, po ashtu anëtarja e pranishme në testin me shkrim ka bërë të njohur faktin që kamë qenë ankuese në Këshill për procedurën përkatëse e cila ka ndikuar që të ketë ritestim të testit me shkrim, fakt ky që cenon identitetin tim si ankuese, gjë që bënë shkelje të ligjit për privatësi-Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me kërkesën që Këshilli të aprovoi ankesën e saj ndërsa të anulohet testi me shkrim.

Kolegji i Këshillit, mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar shpalljen e Konkursit me numër reference RN00017734 për pozitën e kategorisë Grupi i arkiv – dokumentacionit , profesional 2, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka konstatuar se kërkesa të përgjithshme formale në procedurën përkatëse të rekrutimit kanë qenë **Arsimimi i kërkuar:** Diplomën arsimit të lartë e nivelit të parë Bachelor në drejtimet: Juridik/ Histori/Letërsi/Arkivistikë/Orientalistikë /Antropologji, Ballkanistikë; **Përvoja e punës e kërkuar:** Së paku në vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës, nga rrjedh se kërkesat e përgjithshme formale të cekura si më lartë janë vendosur në pajtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, përkatësisht Shtojcën Nr.1/3 lidhur me përshkrimin e përgjithshëm të punës për Profesional 2 si dhe katalogun e vendeve të punës në shërbimin civil.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit, në kontest të shqyrtimit të kësaj procedure rekrutimit dhe duke u bazuar në dispozitat e sipër theksuara ligjore, ka analizuar Aplikacionin e kandidates A.A të datës 06.05.2025, nga i cili rezulton se e njëjta si dëshmi për plotësimin e kriterit arsimor ka bashkangjitur Diplomën me Nr.4957, të datës 28.09.2017 të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina“, me të cilën kandidatja A.A mori titullin Juriste e Diplomuar me datë 23.06.2017, rrjedhimisht me këtë rast e njëjta dëshmon se ka plotësuar kriterin arsimor të përcaktuar me konkursin e lartë cekur, ndërsa sa i përket plotësimit të kriterit të përvojës një (1) vjeçare të punës profesionale, në bazë të vërtetimit të datës 31.10.2023 dëshmohet se kandidatja e shpallur fituese ka qenë e angazhuar Zyrtare për Dokumente në kompaninë General Mont “shpk” në periudhën 01.05.2020 deri më datën 31.10.2023, e cila është e mbështetur me pasqyrën e Trustit Pensionale, dhe po ashtu posedon Referencën e lëshuar me datë 06.05.2025 nga OSHP përmes së cilës konfirmohet fakti se e njëjta ka qenë e angazhuar në cilësi të juristes në OSHP që nga data 01.04.2024 e deri me datë 01.05.2025, rrjedhimisht me këtë rast e njëjta dëshmon se ka plotësuar kriterin e përvojës të përcaktuar me konkursin e lartë cekur.

Mirëpo, Kolegji i Këshillit pas konstatimit të gjendjes faktike të pasqyruar si në arsyetimin e këtij vendimi, mori për bazë Rregulloren (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, me theks të veçantë nenit 20 paragrafi 2, ku është përcaktuar se: *“2. Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtarë, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas pozitës për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësues nga NjMBNj; dhe 2.3. një (1) nëpunës i kategorisë profesionale i fushës përkatëse”,* ndërsa përmes Vendimit Nr.1492/25 të datës 16.10.2025 të UD Kryesuesit të Sekretariatit të OSHP-së është themeluar Komisioni i Pranimi prej 5 anëtarësh në këtë përbërje: V.B-Kryetar, i cili sipas Akt të Emërimit Nr.1214/2025 të datës 29.08.2025 mban pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Shërbime Përgjithshme”; S.B-anëtar, i cili sipas Akt të Emërimit Nr.1219/2025 të datës 29.08.2025 mban pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ankesave”; A.B-anëtare, e cila sipas Akt të Emërimit Nr.1219/2025 të datës 01.09.2025 mban pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Burime Njerëzore”; E.P-anëtare, e cila sipas Akt të Emërimit Nr.566/2025 të datës 29.04.2025 mban pozitën “Udhëheqës i Divizionit për Çështje Juridike” dhe E.K- anëtare, e cila sipas Akt të Emërimit Nr.010/2025 të datës 26.04.2024 mban pozitën “Zyrtare e Arkivës”, nga rrjedh se Komisioni i Pranimi është themeluar në pajtueshmëri me paragrafin 2, neni 20 të Rregullos (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil dhe nenin 40 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses, fillimisht Kolegji i Këshillit, analizoi testin me shkrim të ankueses dhe konstatoi se e njëjta nga testi me shkrim kishte arritur të grumbullonte gjithsejtë 48.2 pikë (prej të cilave 44 pike nga pyetjet me përgjigje opsionale, kurse 4.2 pikë nga eseja), ndërsa kandidatja e suksesshme nga testi me shkrim kishte arritur të grumbullonte gjithsejtë 59 pikë (prej të cilave 46 pike nga pyetjet me përgjigje opsionale, kurse 13 pikë nga eseja), dhe me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses lidhur me vlerësimin e eses apo testimit me shkrim, Kolegji i Këshillit mori për bazë dispozitat e nenit 4 të Rregullore (QRK) NR. 05/2024 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullos (QRK) NR. 15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil ku përcaktohet: *“Obligohet ministria përgjegjëse për administratën publikë që brenda një (1) viti nga miratimi i kësaj Rregulloreje, të hartojë një bazë të dhënash me pyetje për testimin me shkrim dhe/apo intervistën me gojë. Deri në krijimin e kësaj baze të dhënash, Komisioni i Pranimi në përbërje të plotë është i obliguar që jo më herët se njëzet e katër (24) orë para mbajtjes së testit, të hartojë pyetjet e testit me shkrim të modelit zgjedhje e shumëfishtë me një përgjigje të saktë, si dhe një ese me shkrim, duke marrë parasysh fushat e njohurive dhe aftësive të përcaktuara 3/4 në shpalljen për rekrutim. Pyetjet vendosen në sistemin elektronik nga Komisioni, i cili administron procesin e testimit”*, si dhe dispozitat e nenit 9 paragrafi 6 dhe 8 të Rregullos (QRK) 16/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ku përcaktohet se: *“6. Testi me shkrim përmban gjithsej njëzet e pesë (25) pyetje dhe një (1) ese të shkurtër. Secila përgjigje e saktë vlerësohet me dy (2) pikë, ndërsa eseja mund të vlerësohet me më së shumti njëzetë (20) pikë. 8. Anëtarët e Komisionit të Pranimi, vlerësojnë testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, më së voni në afat prej dhjetë (10) ditësh nga dita e përfundimit të tij. Pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë vlerësohen nga sistemi në mënyrë elektronike, ndërsa eseja vlerësohet nga Komisioni i Pranimi”*, dhe konstatoi se sistemi që funksion në kuadër të SIMBNJ-së, është i programuar në atë mënyrë, ashtu që përgjigjen e saktë e ka të identifikueshme dhe vlen njëtrajtshëm për të gjithë kandidatët që i nënshtrohen testimit me shkrim, sikurse edhe në rrethanat e rastit konkret, ndërsa Komisioni i Pranimi e vlerëson vetëm esenë, nga rrjedh se sipas testit me shkrim

të datës 21.10.2025 me shifër/kod aplikimi CN6581-ankuesja për vlerësimin e eses nga anëtarët e komisionit është vlerësuar me gjithsejtë (4.2) pikë, sikurse përcaktohet me dispozitat e nenit 9 paragrafi 9 të së njëjtës rregullore: “9. Eseja vlerësohet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimi në mënyrë individuale, të cilët e nënshkruajnë formularin e vlerësimit dhe vendosin pikët në SIMBNJ. Mbledhja e pikëve të secilit anëtar të Komisionit, nxjerr mesataren e vlerësimit përfundimtar për ese nga ana e Komisionit, për një kandidat të caktuar. **Shuma e pikëve të vlerësuara nga sistemi dhe pikëve të esesë, përbën vlerësimin përfundimtar të testimit me shkrim**”, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit konstatoi se pretendimet e ankueses nuk janë të bazuara, ngase Komisioni i Pranimi asnjërin nga kandidatët nuk e ka vlerësuar me 20 pikë, aq sa është edhe maksimumi i vlerësimit të eses, respektivisht ankuesen e ka vlerësuar me gjithsejtë 5 pikë, kurse kandidatin e suksesshëm B.P e ka vlerësuar në ese me 13 pikë, ashtu që Kolegji i Këshillit nuk gjeti se në këtë fazë ka pasur shkelje sikurse ankuesja pretendon, për rrjedhojë ankuesja nuk ka arritur ta argumentojë faktin me asnjë provë se për çfarë arsye e njëjta është dashur të vlerësohet me më shumë pikë në esenë me shkrim, ngase eseja me shkrim ka qenë “**Në cilat raste i nënshtrohen përgjegjësisë personat fizik dhe juridik për veprat kundërvajtëse dhe çfarë ndëshkimi parashihet me ligj**”, përgjigja e së cilës është ekuivalente me përcaktimet ligjore nga neni 22, 23 dhe 24 Ligji Nr.08/L-111 Për Arkivat, ashtu që kandidatja e suksesshme ka dhënë përgjigje sipas referencave ligjore, ndërsa ankuesja nuk ka qenë specifike në përgjigjen e saj, nga rrjedh se pretendimi ankimor i ankueses nuk është i bazuar.

Po ashtu, dispozitat e aplikuara nga ligji material rreth procedurës së mbajtjes së testit me shkrim, gjegjësisht neni 9 i Rregullores (QRK) 16/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nuk e ka përcaktuar askund se gjatë mbajtjes së testimit me shkrim të gjithë anëtarët duhet të qëndrojnë prezent në sallë, respektivisht një çështje e tillë nuk gjen zbatim në praktikë, ndërsa sistemi i cili menaxhohet në atë mënyrë nga DMZP, saqë pa aprovimin e të gjithëve anëtarëve të Komisionit të Pranimi, nuk do të mund të zhvillohej fare testimi, prandaj në rrethanat e rastit konkret për aq kohë sa ankuesja iu ka nënshtruar testimit del që ky hap procedural është zbatuar në mënyrë të drejtë nga organi përkatëse, ndërsa mos prezenca e të gjithë anëtarëve të komisionit përkatëse në sallë gjatë mbajtjes së testit me shkrim, nuk përbën shkelje procedurale dhe as materiale, ndërsa lidhur me pretendimin ankimor të ankueses se të njëjtës njëra nga anëtarët e Komisionit të Pranimi ia ka zbuluar identitetin e ankueses, ankesë përmes të cilës është përsërit testimi me shkrim, Kolegji i Këshillit thekson faktin se nuk ka mandatin ligjor edhe as kompetencën lëndore të trajtojë çështje që bien në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, ngase sipas Ligjit Nr. 06/L-082 Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale organi kompetentë për këtë fushë është Agjencia për Informim dhe Privatësi, andaj Kolegji i Këshillit për këtë çështje palët i udhëzon që t’iu drejtohen organeve përgjegjëse të fushës sipas përcaktimeve ligjore të kuadrit ligjor në fuqi.

Prandaj, duke u bazuar në konstatimet si më sipër, Kolegji i Këshillit, konstaton se meqenëse në asnjërin nga konstatimet e dhëna nuk u gjet se ankuesja ka të drejtë në pretendimin e saj ankimor, respektivisht pretendimet e saja janë të pabazuara, prandaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi, ndërsa akti i kontestuar, Njoftimi i datës 28.10.2025, i Njësisë së Burimeve Njerëzore të Organit Shqyrtues të Prokurimit, u la në fuqi, ngase procedura e rekrutimit për pozitën e punës, “Zyrtar për Arkiv 2” me Reference RN00017734 është zhvilluar në pajtueshmëri me dispozita e aplikuara nga neni 7 paragrafi 1 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: “1.Pranimi në detyrë i nëpunëses/it civil,

nëpunëses/it së shërbimit publik, krijueses/it dhe performueses/it së artit dhe kulturës, si dhe nëpunëses/it teknik dhe mbështetës, bazohet në parimin e meritës, e mundësive të barabarta, profesionalizmit dhe integritetit, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë dhe të barabartë gjinor dhe të komuniteteve, përmes një procedure të hapur dhe konkurruese”.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 , Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda:A.nr.1870/2025, datë 10/12/2025

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses M.D.K;
- Organit Shqyrtues të Prokurimit (Udhëheqëses së Divizionit të Burimeve Njerëzore), si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.